

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT  
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

**Drejtuar: Operatori ekonomik "BEQIRI" shpk**

**Adresa:** Fier, Lagjja 15 Tetori, rruga Todi Shkurta, pallati 10 katësh me nr-47/2, kati i dyte.

Procedura e prokurimit: "Procedurë e Hapur".

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-08198-06-05-2024**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: **"Ndërtim Ura e Bonarakëve, Ibë e Poshtme"**

**Fondi limit: 79,515,159.68** (shtatëdhjetë e nëntë milion e pesëqind e pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë pikë gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

**Burimi i financimit:** *Të ardhurat e Bashkisë Tiranë për vitin 2024* miratuar me VKB Nr.36, date 28.03.2024 "per disa shtesa dhe ndryshime ne vendimin Nr.125, datë 22.12.2023 "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2024".

**Kohëzgjatja e kontratës:** 6 (gjashtë) muaj.

**Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 21 / 06 /2024 Ora 10: 00**

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr.44 datë 05.08.2024.

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

oferta ekonomisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. Operatori ekonomik "S I R E T A 2F" shpk**

NIPT K51501008J

Vlera e ofertës: **61,111,111.00** (gjashtëdhjetë e një milion e njëqind e njëmbëdhjetë mijë e njëqind e njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

**2. Bashkimi i operatoreve ekonomike GLAVENICA shpk & NGRACAN 1934 shpk**

NIPT K17710805A & J87602809S

Vlera e ofertës: **68,573,946.00** (gjashtëdhjetë e tetë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e dyzet e gjashtë) lekë pa TVSH.

**3. Operatori ekonomik "SENKA" shpk**

NIPT J94808405Q

Vlera e ofertës: **71,563,582.34** (shtatëdhjetë e një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e pesëqind e tetëdhjetë e dy pikë tridhjetë e katër) lekë pa TVSH.

**4. Operatori ekonomik "BEQIRI" shpk**

NIPT J98624801V

Vlera e ofertës: **74,581,447.50** (shtatëdhjetë e katër milion e pesëqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind e dyzet e shtatë pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

## **5. Operatori ekonomik “INA” shpk**

NIPT J61814009W

Vlera e ofertës: **78,048,245.75** (shtatëdhjetë e tetë milion e dyzet e tetë mijë e dyqind e dyzet e pesë) lekë pa TVSH.

*Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:*

### **1. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “SENKA” shpk**

Nga kontrolli aritmetik i ofertes ekonomike te paraqitur nga operatori ekonomik SENKA shpk, rezultoi se oferta e paraqitur eshte me gabim mbi 2 %.

### **2. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “S I R E T A 2F” shpk**

Operatori ekonomik “S I R E T A 2F” shpk në Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit, Pjesa III, Kategoria C *”Deklaratë Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”*, ka deklaruar se disponon 1 (një) Autobetoniere me targa AA 582UZ, sipas Kontrates se Qerase Nr.6886 Rep e Nr.3332 Kol., date 02.05.2024 (me afat 5 vjcar). Pas verifikimit te dokumentacionit te dorezuar, u konstatua se mungon dokumentacioni per mjetin Autobetoniere me targa AA 582UZ, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 11.

Operatori ekonomik “S I R E T A 2F” shpk në Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit, Pjesa III, Kategoria C *”Deklaratë për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”*, ka deklaruar se disponon 1 (një) Sonde shpimi per pilota, sipas Kontrates se Qerase Nr.134 Rep e Nr.89 Kol., date 06.01.2023 (me afat 5 vjcar). Pas verifikimit te dokumentacionit te dorezuar, u konstatua se mungon dokumentacioni per 1 (nje) Sonde shpimi per pilota, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 11.

Operatori ekonomik “S I R E T A 2F” shpk në Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit, Pjesa III, Kategoria C *”Deklaratë Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”*, ka deklaruar se disponon 1 (një) Autovinc 100 Ton me targa AA 582 JN, sipas Kontrates se Qerase date 19.06.2024 (me afat deri ne perfundim te punimeve). Pas verifikimit te dokumentacionit te dorezuar, u konstatua se mungon dokumentacioni per mjetin Autovinc 100 Ton me targa AA 582 JN, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 11.

Operatori ekonomik “S I R E T A 2F” shpk në Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit, Pjesa III, Kategoria B *”Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”*, ka deklaruar punonjesin me profesion Buldozerist z.Thanas Bico. Pas verifikimit te dokumentacionit te dorezuar, u konstatua se mungon kontrata e punes per punonjesin Buldozerist, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 8.

### **3. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “GLAVENICA” shpk**

Operatori ekonomik “GLAVENICA” shpk nuk permbush Kriteret e Pergjithshme te Kualifikimit, pika 3, ku percaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt...”*. Nga verifikimi dokumentacionit te paraqitur ne sistemin elektronik te prokurimit rezultoi se operatori ekonomik “GLAVENICA” shpk per permbushjen e kriterit te mesiperem, ka deklaruar punonjesin me iniciale V.N i cili nga deklarimi perkates rezulton Ing. Topograf, cka bie ne kundërshtim me udhezimin Nr.2, date 13.05.2005, Kreu I, pika 2.1, paragrafi 2, ku citohet se: *“Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30,000,000 (tridhjetë milionë) lekë,*

*përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi”.*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “BEQIRI” shpk** me adresë, Fier, Lagjja 15 Tetori, rruga Todi Shkurta, pallati 10 katësh me nr-47/2, kati i dyte se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra* **74,581,447.50** (shtatëdhjetë e katër milion e pesëqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind e dyzet e shtatë pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej 78,048,245.75 (shtatëdhjetë e tetë milion e dyzet e tetë mijë e dyqind e dyzet e pesë) lekë pa TVSH, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO  JO

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të Procedurës:

PO  JO